



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË VUSHTRISË**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Vushtrrisë*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ylber Sadiku* udhëheqës ekipi, *Fisnik Rudaj* anëtar dhe *Muharrem Qyqalla* anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	7
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	9
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	31
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	37
Shtojca II: Letra e konfirmimit	39

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Konkluzioni për Pasqyrat Financiare Vjetore - Disa pozicione në Pasqyrat Financiare Vjetore ishin korrigjuar pas sugjerimeve tona. Megjithatë, Pasqyrat Financiare Vjetore ishin në përputhje të plotë me rregullat dhe me Standardet e zbatueshme, me përjashtim të keq-klasifikimit të shpenzimeve në mes të kategorive të ndryshme ekonomike. Kjo është shpjeguar në detaje tek Paragrafi për Theksimin e çështjes.

Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin - Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, menaxhimi financiar dhe kontrolli është përcjellë me dobësi evidente në disa sisteme të rëndësishme financiare. Kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar: keqklasifikimin e shpenzimeve, anashkalimin e rregullave të prokurimit, menaxhimin e projekteve kapitale dhe për të shmangur rritjen e pagesave me vendime gjyqësore.

Konkluzioni për zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak - Zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak nuk monitorohet në nivelin e duhur, dhe nuk ka progres në zbatimin e tyre. Përkundër veprimeve të ndërmarra, ka nevojë për veprime shtesë për zbatimin e rekomandimeve tona.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës së Vushtrrisë gjatë procesit të auditimit.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Vushtrrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vemëndjen tuaj për faktin se përmes planifikimit buxhetor Komuna kishte keq klasifikuar shpenzime në vlerë 438,567€, dhe 56,428€ nga pagesat e bëra nga thesari si pasojë e vendimeve gjyqësore/përmbartimore. Më gjërësisht shih tek nënkapitulli 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në web faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si të ndjeshme apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë, kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtjeshëm për të parandaluar: keqklasifikimin e shpenzimeve, anashkalimin e rregullave të prokurimit, menaxhimin e projekteve kapitale dhe për të shmangur rritjen e pagesave me vendime gjyqësore.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	19,119,355	20,480,036	17,784,421	87	16,614,801	14,936,159
Granti i Qeverisë - Buxheti	16,356,113	16,356,113	15,369,953	94	14,760,460	13,244,927
Të hyrat vetjake ³	2,546,784	2,546,784	1,550,507	61	1,024,423	1,286,793
Të hyrat e bartura nga viti paraprak ⁴	0	1,035,528	497,100	48	722,774	324,723
Donacionet e brendshme	0	179,293	111,142	62	57,774	53,767
Donacionet e jashtme	0	192,264	106,186 ⁵	55	10,654	25,949
Huamarrja	216,458	1,418.13	89,534	98	38,716	0
Pranimet tjera ⁶	0	78,636	60,000	76	0	0

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake

⁴ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual

⁵ Është përfshirë edhe një pagesë direkte 6,000€ e cila nuk ka kaluar përmes LLVTH dhe e njëjta është shpalosur në PVF

⁶ Depozita nga fondi i mirëbesimit për shpronësimin e pronave – vlera 78,636€ është depozitë e bartur nga viti paraprak përderisa gjatë 2019 është realizuar vlera 60,000€.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,360,681€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak për 1,035,528€, rritjes së donacioneve të brendshme për 179,293€, rritjes së donacioneve të jashtme për 192,264€ si dhe depozitave të bartura nga viti paraprak prej fondit të mirëbesimit për shpronësimin e pronave për 78,636€. Përderisa, financimi nga huamarrja ishte zvogëluar për 125,040€.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 87% të buxhetit final ose 17,784,421€, me një përmirësim prej 7% krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale të realizimit të buxhetit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	19,119,355	20,480,036	17,784,421	87	16,614,801	14,936,159
Pagat dhe Mëditjet	10,207,561	10,241,650	9,936,267	97	9,772,738	9,450,294
Mallrat dhe Shërbimet	3,083,496	3,234,502	2,528,131	78	2,006,102	1,397,121
Shërbimet komunale	309,035	321,440	274,878	86	257,594	232,614
Subvencionet dhe Transferet	192,914	195,651	195,167	100	179,792	187,426
Investimet Kapitale	5,326,349	6,408,158	4,789,977 ⁷	75	4,398,575	3,668,704
Pagesat tjera ⁸	0	78,636	60,000	76	0	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 34,089€ si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak;
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti ishte rritur për 151,006€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura për 278,883€, nga grantet e donatorëve 7,000€, kishte zvogëlim nga fondi i huamarrjes për 127,950€. Buxheti për shërbimet komunale ishte rritur për 12,405€ nga të hyrat e bartura;
- Buxheti për subvencione ishte rritur për 2,737€ nga të hyrat e bartura;
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,081,809€, si rezultat i të hyrave të bartura 707,413€, të hyrat nga grantet 371,488€ dhe nga huamarrja për 2,910€; dhe

⁷ Është përfshirë edhe një pagesë direkte prej 6,000€ e cila nuk ka kaluar përmes LLVTH dhe e njëjta është shpalosur në PVF

⁸ Depozita nga fondi i mirëbesimit për shpronësimin e pronave - vlera 78,636€ është depozitë e bartur nga viti paraprak përderisa gjatë 2019 është realizuar vlera 60,000€

Çështja C1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Bazuar në Udhëzuesin Administrativ NR. 19/2009 për planin kontabël për përdorim nga Organizatat Buxhetore – Kodi ekonomik nënkupton natyrën e shpenzimeve dhe të hyrave në regjistrin e buxhetit.

Siç kemi cekur tek theksimi i çështjes Komuna kishte buxhetuar dhe paguar gabimisht shpenzimet në vlerë 438,567€. Këto shpenzime është dashur të planifikohen dhe paguhet nga Subvencionet dhe Transferet, ndërsa janë planifikuar dhe paguar nga: mallrat dhe shërbimet 131,139€⁹, dhe nga investimet kapitale 307,428€¹⁰.

Poashtu, shpenzimet për Paga dhe Mëditje prej 56,240€ të ekzekutuara nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore janë paguar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve. Këto shpenzime kanë të bëjnë me detyrimet e dala nga marrëveshja kolektive për pagesë të tri pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve.

Keqklasifikimet kanë ndodhur pjesërisht për shkak të planifikimit të gabuar dhe pjesërisht për shkak të obligimeve që janë krijuar nga marrëveshja e përgjithshme kolektive.

Ndikimi Planifikimi jo i mirë i buxhetit nëpër kategori ekonomike ka ndikuar në keqklasifikimin e shpenzimeve. Ndërsa, raportimi apo klasifikimi jo i duhur i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktivitetëve financiare të komunës.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që të gjitha shpenzimet të planifikohen në kategoritë e duhura buxhetore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate. Këtu duhet të përfshihen planifikimi i mjeteve për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse për ish punëtorët që nuk janë kompensuar si dhe ata që janë në prag të pensionimit, si dhe klasifikimi/ndarja e qartë e projekteve kapitale nga shpenzimet tjera si subvencionet apo mallrat dhe shërbimet.

⁹ Pagesat e bëra nga Mallrat dhe Shërbimet janë: 97,440€ për "Shërbimet e varrimit për qytetarë"; 31,518€ për "Zbatimin e programeve aktive të tregut të punës" dhe 2,181€ për mbështetjen e dy studentëve, me bileta aeroplani në funksion të vazhdimin të studimeve jashtë vendit.

¹⁰ Pagesat e bëra nga Investimet Kapitale janë: 55,958€ për "Mbulimin e normave të interesit për kredimarrësit"; 26,200€ për "Furnizim dhe montim të serave"; 117,194€ për "Furnizim me pajisje për përkrahje të bizneseve" LOT1; 13,900€ për "Furnizim me pajisje për përkrahje të frizerkave" LOT 2; 19,140€ për "Furnizim me makina për mjeljen e lopëve"; 9,470€ për "Furnizim me makina për lëvrimin e kopshteve për nevoja të fermerëve"; 17,863€ për "Ngritjen e pemishteve - arrë dhe lajthi"; 7,680€ për "Furnizim dhe montim të serave - faza e dytë"; 4,090€ për "Furnizim me freza dhe pllugj për nevoja të bujqëve"; 30,380€ për "Furnizimi me makina spërkatëse për nevoja të bujqëve" 708€ për "Furnizim me IT dhe pajisje për AK Vushtrri" dhe disa kontrata me vlera minimale më vlerë totale 4,843€ për furnizimin me pajisje të IT dhe pajisje tjera për shkollat të financuara nga huamarrja.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e përgjithshme të realizuara nga komuna e Vushtrrisë në vitin 2019 ishin 2,122,937€ apo rreth 50% më shumë se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksa për grumbullimin e mbeturinave, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 235,784€, dhe gjobat nga gjykatat 9,620€. Poashtu komuna kishte pranuar donacione në vlerë 352,663€.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e Realizimit 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,546,784	2,546,784	2,122,937	83	1,586,465	2,021,801
Të hyrat tatimore	880,401	880,401	820,800	93	661,711	578,400
Të hyrat jo tatimore	1,666,383	1,666,383	1,302,137	78	925,754	1,443,401

Çështja C2 - Dobësi në menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë

Gjetja

Nga mostrat e testuara për pajtueshmërinë me rregulloret dhe ligjet në fuqi mbi vlerësimin e bazës tatimore kemi identifikuar dobësitë në vijim:

- Nuk ka harmonizim mes nenit 8 të Rregullores komunale Nr. 02/2018 për Tatimin në pronën e paluajtshme dhe të dhënave në sistemin ProTax për vlerësimin e bazës tatimore për kategorinë e pronave - objektet e pa përfunduara dhe jo të gatshme për banim. Kjo është hasur gjatë testimit të një tatim paguesi të zonës së I-rë, që në vend të llogaritjes 160€ për m² është bërë me vlerën 132€ për m². Ne kemi analizuar këtë kategori të pronës në ProTax dhe kemi evidentuar se janë 105 objekte (nga zona I deri V) në të cilat caktimi i bazës tatimore nëpër zona nuk është caktuar sipas rregullores komunale¹¹.
- Neni 11 i Ligjit Nr. 06/L-005, përcakton se zbritja prej 15,000€ për vendbanimin parësor është e lejueshme vetëm për personat fizik. Në një rast kemi evidentuar se zbritja ishte aplikuar në gjashtë (6) njësitë e objekteve të një tatim paguesi i cili ishte person juridik. Rrjedhimisht vlera totale e vlerësuar e objekteve është zvogëluar për 90,000€ duke zvogëluar në këtë mënyrë edhe tatimin e arkëtuar.

¹¹ Baza tatimore sipas rregullores nëpër zona: Zona I=160€, II=140€, III=120€, IV=110€ dhe zona V=100€. Ndërsa në ProTax vlera e përcaktuar ishte: Zona I=132€, II=116€, III=100€, IV=92€ dhe zona V=84€.

Derisa për rastin e parë zyrtarët e komunës nuk ishin në dijeni për këto dallime, për rastin e dytë deklarojnë për një anomali në sistemin ProTax.

Duket theksuar se në sistemin ProTax ende figurojnë tatimpagues pa numër të personal, ndonëse komuna është në proces të përmirësimit përmes verifikimit të pronave, regjistrimeve të reja dhe bashkëpunimit me qytetarë.

Ndikimi Nënvlërësimi i bazës tatimore për pronat e pa përfunduara dhe jo të gatshme për banim si dhe aplikimi i zbritjeve për vendbanimin parësor në njësitë e objekteve të tatim paguesve juridik, ndikon në uljen e vlerës totale të vlerësuar të objekteve për tatim dhe rrjedhimisht ka ndikuar që të arkëtohen me pak të hyra.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen.

Çështja A1 - Mos inspektimi i 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës

Gjetja Sipas neni 15.2 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Komuna e Vushtrrisë nuk ka arritur të kryej këtë inspektimin gjatë vitit 2019. Nga 21,384 objekte që figurojnë në sistemin ProTax, janë verifikuar gjithsej 2,451 objekte apo 11.46%.

Sipas zyrtarëve të komunës, ndër shkaqet kryesore për mos arritjen e përqindjes së kërkuar të inspektimeve, janë problemet në fillim të vitit me tabletat elektronik si dhe nga neglizhenca e punëtorëve të terrenit.

Ndikimi Mos verifikimi i 20% i të gjitha objekteve brenda komunës mund të ndikojë që komuna të ketë informata jo të plota rreth pronës së tatueshme aktuale, pasi nuk përfshihen ndryshimet në prona. Kjo ndikon edhe në planifikim jo të saktë të vlerës së të hyrave dhe projekteve që synohet të financohen nga to.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 10,241,650€. Numri i aprovuar i të punësuarve, sipas buxhetit ishte 1,587 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,540. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 55 punëtor të rinj. Kemi testuar 54 mostra për teste substanciale në vlerë 25,926€, si dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B1 - Mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta

Gjetja Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MSHV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2019 kishte 34 punonjës të angazhuar me MSHV. Prej tyre, 25 ishin të angazhuar nga viti 2018. Për të gjitha rastet fillimisht janë përdorë procedura të thjeshtësuar të rekrutimit, përderisa 21 prej tyre ju kishte vazhduar kontrata deri në tri herë edhe për gjashtë muaj tjerë me kërkesë nga drejtoritë përkatëse ku ishin të angazhuar. Këto shërbime ishin kryesisht për pozita të rregullta¹². Arsyeja pse janë lidhur këto kontrata ishte mungesa e planifikimit buxhetor për këto pozita, dhe mundësia më e lehtë e angazhimit në këtë formë.

Ndikimi Mbulimi i pozitave të rregullta me MSHV rrit rrezikun që punët të mos kryhen me cilësinë e duhur, duke marrë parasysh se angazhimi i stafit me kontrata afatshkurta mund të jetë më i pakët në krahasim me punëtorët e rregullt, rrjedhimisht mund të dëmtohet performanca e komunës. Derisa kontraktimi i shërbimeve të veçanta, respektivisht vazhdimi i MSHV-ve pa procedura të reja kufizon konkurrencën dhe si pasojë mund të pranohet staf me kompetencë jo të duhur.

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të siguroj se MSHV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.

¹² Zyrtarë për Leje Ndërtimore, Zyrtarë për Shërbim me qytetarë, Zyrtarë për Digjitalizim, Asistentë, Mirëmbajtës të Lumenjëve, Pylltarë etj.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2019 ishte 3,555,941€, prej tyre ishin shpenzuar 2,803,009€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, shërbime komunale, furnizime të ndryshme për zyre, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve etj. Kemi testuar 44 mostra për teste substanciale në vlerë 398,558€ si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Vonesa në liferimin e mallrave

Gjetja Në dy pagesa kemi hasur vonesa në liferim të mallrave dhe nuk ishin aplikuar ndëshkimet/penalet e përcaktuara me kontratë. Rastet janë:

- Pagesa prej 13,139€ për kontratën “Furnizim me lëndë djegëse – dru për ngrohje për nevoja të A.K Vushtrri”, vonesat ishin 46 ditë mbi afatin 10 ditor të përcaktuar në nenin 2.1 të kontratës;
- Pagesa prej 2,880€ për kontratën “Furnizim me inventar për shkolla Lot 2” vonesat ishin nga 3 deri 20 ditë kalendarike, mbi afatin 30 ditorë të përcaktuar në nenin 1.2 të kontratës.

Arsyeja e vonesave ishte menaxhimi jo i duhur i kërkesave për furnizim nga komuna si dhe papërgjegjshmëria e Operatorit Ekonomik.

Ndikimi Vonesat në liferimin e mallit mund të paraqesin pengesë për zhvillimin e aktiviteteve operacionale të komunës ndërsa mos aplikimi i penaleve përveç ndikimit financiar, ndikon edhe në uljen e përgjegjësisë së OE në përmbushjen e afateve të kontraktuara.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve të kontraktuara, dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.

Çështja B3 - Mangësi në menaxhimin e kontratave

Gjetja Neni 61 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), përcaktohen përgjegjësitë e menaxherit të projektit. Kemi evidentuar dy raste në të cilat pagesat janë ekzekutuar në mungesë të raporteve të menaxherëve të kontratave, përkatësisht:

- Pagesa prej 4,736€ për drekë zyrtare për përmbylljen e vitit 2019, të kontratës “Shërbime Hoteliere për A.K”. Mungesa e raportit është arsyetuar me volumin e madh të punëve të fund vitit; dhe

- Paguesa prej 1,120€ sipas kontratës së AQP-së për "Furnizimin me karburante për nevoja të A.K" për muajin qershor për QKMF. Mungesa e raportit ishte si pasojë e mungesës së njohurive së menaxherit të kontratës lidhur me kërkesat ligjore për menaxhimin e kontratës.

Ndikimi Mungesa e raporteve nga menaxherët e kontratave, mund të ndikojë në menaxhim/monitorim të dobët të kontratave si dhe mund të rezultojë me pagesa të pa rregullta.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj që të bëhet monitorimi i zbatimit të kontratave përmes hartimit të raporteve nga menaxherët përkatës, dhe se asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen nga ana e OE.

Çështja B4 - Shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore

Gjetja Neni 39 i LMFP ka përcaktuar se çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim të mallrave dhe shërbimeve të furnizuara ose punëve të realizuara duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës së vlefshme për pagesë. Po ashtu Ligji Nr. 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike.

Ne kemi identifikuar se Thesari kishte ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë prej 64,236€. Pagesat kishin të bëjnë me detyrimet e dala nga marrëveshja kolektive për kompensimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve në vlerë 56,240€ dhe 7,996€ tjera për mallra/shërbime dhe komunal. Kjo formë e pagesave, përveç ndikimit në keqklasifikimin e shpenzimeve (që është trajtuar tek opinioni i auditimit), ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve, ngase borxhi kryesor ndaj pretenduesve ishte 51,353€ ndërsa shpenzimet procedurale të gjykatës/përmbarrimit ishin 12,883€.

Arsyet e ekzekutimit të pagesave të tilla vijnë si rezultat i planifikimit të dobët dhe mungesës së buxhetit nga Drejtoria e Arsimit për këto raste.

Ndikimi Situata e krijuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga ana e Thesarit përmes procedurave të përmbarrimit ka ndikuar në rritjen e kostos për Komunën dhe në keqklasifikimin e shpenzimeve.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të thelloj bashkëpunimin me MF, për të siguruar që mjetet për kryerjen e obligimeve që dalin nga marrëveshja kolektive të buxhetohen dhe të paguhen me kohë dhe nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, për të shmangur keqklasifikimin dhe shpenzimet e panevojshme.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 195,651€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 195,167€. Ato janë dhënë për entitete publike dhe jopublike dhe kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e sektorit të bujqësisë, kulturës, sportit dhe aktiviteteve tjera në kuadër të komunës. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 34,647€ si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C3 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja Kemi identifikuar disa çështje në menaxhimin e subvencioneve të cilat kishin të bënin me mangësitë në përcaktimin e kritereve për aplikim, mos respektim të kritereve gjatë vlerësimit si dhe menaxhimin/monitorimin e tyre:

- Për tri thirrjet publike: "Grante për zhvillimin e sektorit privat - lot 1 për bizneset fillestare", "Frezë për traktor" dhe "Serë e tipit tunel 0.5 ari", kemi vërejtur se thirrjet për aplikim nuk kishin përcaktuar kritere të matshme dhe specifike për përzgjedhjen e përfituesve potencial. Kjo ka bërë që pothuajse të gjithë aplikantët të plotësojnë kriteret, andaj komisionet kanë përdorur nën kritere tjera për selektim që nuk ishin të shkruara/dokumentuara. Për më tepër, për aplikuesit e refuzuar, zyrtarët komunal nuk kanë arritur të na dëshmojnë këtë vlerësim;
- Gjatë vitit 2019 komuna ka paguar 55,958€ sipas kontratës që kishte me një bankë komerciale për "Mbulimin e normave të interesit për kredimarrësit". Qëllimi i kësaj kontrate ishte përkrahja në zhvillimin e agro bizneseve dhe bizneseve tjera përmes subvencionimit të kamatës për kreditë që do të ndahen kredimarrësve. Nga testimi i thirrjeve publike/pagesave, kemi evidentuar se nuk ka siguri se është arritur objektivi i kësaj kontrate. Ky konstatim rrjedh nga fakti se, neve nuk na janë ofruar dëshmi të cilat vërtetojnë se interesi i paguar nga ana e komunës ishte për qëllimet e përcaktuara në kontratën e komunës me bankën, dhe vetëm pas sugjerimeve tona komuna ka filluar të angazhohet në këtë drejtim për të verifikuar nëse shpenzimet e komunës janë konform qëllimeve të përcaktuara. Po ashtu komuna nuk kishte ngritur mekanizma për tu siguruar se pagesat e komunës po shfrytëzohen për qëllimet e përcaktuara.
- Te thirrja publike e Departamentit për Kulturë Rini dhe Sport (DKRS) për financim të projekteve të OJQ-ve, kemi evidentuar se një përfitues i subvencionit prej 20,000€, nuk kishte plotësuar kriteret e thirrjes publike lidhur me vërtetimin se nuk ka borxhe në ATK (neve na është ofruar

dëshmi vërtetimi i ATK-së me borxhe, e cila është e vitit 2017) dhe nuk kishte sjellur fare çertifikatën se nuk është nën hetime (një çertifikatë e sjellur më vonë dëshmon se bartësi i OJQ-së ishte nën hetime). Po ashtu, edhe te thirrja publike në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë, përfituesi i subvencionimit prej 12,000€ nuk kishte plotësuar kriterin lidhur me vërtetimin se nuk ka borxhe në ATK (vërtetimi i ATK dëshmon se OJQ kishte borxhe të pashlyera).

Shkaku kryesor për situatën aktuale të pikës një dhe dy, është mungesa rregullore për ndarjen e subvencioneve për Drejtorinë e Bujqësisë. Kurse për pikën e tretë, arsyet kryesore të ndodhjes së situatave të tilla, sipas komisionit vlerësues janë gjendja e rëndë e përfituesve.

Ndikimi

Mos përcaktimi i kriterëve të matshme me rastin e përpilimit të thirrjeve për aplikim si dhe mos përfillja e kriterëve të thirrjes publike, ka vështirësuar procesin e vlerësimit të aplikuesve, ka ndikuar në përzgjedhjen e përfituesve pa meritë si dhe ndikon në diskriminimin e aplikuesve tjerë. Mungesa e mekanizmave mbikëqyrës lidhur me shfrytëzimin e subvencioneve të dhëna mund të ndikojë që ato të mos përdoren në pajtim me qëllimet e synuara.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës, si dhe përfitues të subvencioneve të jenë vetëm aplikuesit që përmbushin kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. Po ashtu, Kryetari duhet të ndërtojë mekanizma mbikëqyrës për tu siguruar se subvencionet e dhëna arrijnë qëllimet e synuara.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,408,158€ prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 4,789,977€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të shkollave dhe parqeve, shpronësime, blerje të pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit. Kemi testuar 74 mostra për teste substanciale në vlerë 2,455,748€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Ndryshime në pozicionet e kontratës jo kornizë pa aprovimin paraprak të Zyrtarit Kryesor Administrativ

Gjetja Neni 61.21 RrUOPP specifikon se “Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer”, neni 61.22 thotë se “ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit”, ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet “vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtarit Kryesor Administrativ”. Ndërsa, ndryshimet në sasi të kontraktuara janë të lejuara +/- 30% të kontratat kornizë.

Te kontrata "Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Pestovë" prej 69,868€, kishte pasur ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, por pa ndryshuar çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe zyra e prokurimit ashtu siç kërkohet me nenet 61.22 dhe 61.23 të RrUOPP.

Nevoja për ndryshime kishte ardhur për shkak të kërkesës së banorëve lokal për zgjerimin e rrjetit. Ndërsa mos aprovimi i këtyre ndryshimeve ka ndodhur për shkak se menaxheri i projekteve nuk ishte në njohuri për kërkesat ligjore të prokurimit publik lidhur me ndryshimin e kontratave.

Ndikimi Ndryshimi i paramasës dhe paralogarisë së kontraktuar pa aprovimin e zyrës së prokurimit dhe Zyrtari Kryesor Administrativ shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë dhe mund të rezultojë që për shkak të realizimit të kontratës me kushte të ndryshuara nuk është përzgjedhur operatori më i lirë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve) dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga Zyrtari Administrativ.

Çështja B5 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Neni 20 pika 10 i RrUOPP kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten.

Kemi identifikuar se në gjashtë (6) kontrata pune komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte te renovimet dhe ndërtimi i rrugëve. Mungesa e projekteve sipas vlerësimeve të zyrtarëve përgjegjës ishte për shkak të thjeshtësisë së punëve të cilat ishte paraparë për tu kryer.

Ndikimi Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin e profesional ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.

Çështja A3 – Mangësi në çertifikimin e pagesave dhe menaxhimin e kontratave

Gjetja

Në pesë (5) kontrata kemi evidentuar mangësi në çertifikimin e pagesave, dhe menaxhimin e kontratave si në vijim:

- Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i mallrave pastaj duhet të bëhet pagesa. Te kontrata "Furnizimi me pajisje për muzeun e qytetit" prej 37,669€, ishte realizuar pagesa prej 15,000€, bazuar në situacionin e parë, fletëdërgesën si dhe raportin e pranimit të gjitha këto të nënshkruara nga menaxheri i kontratës dhe komisioni pranues. Mirëpo, përmes ekzaminimit fizik në muzeun e qytetit, kemi evidentuar se nuk ishte bërë pranimi i mallrave/punëve. Sipas menaxherit të kontratës, pranimi i mallrave/punëve nuk ishte bërë për këto arsye: ende nuk ishte bërë pranimi teknik i muzeut në të cilin pritej të bëhej furnizimi dhe montimi i pajisjeve, nuk kishte siguri në muze si dhe mungesës së hapësirave për vendosjen e mallrave të blera. Si pasojë, sipas menaxherit të kontratës mallrat kanë qëndruar në depon e OE. Mirëpo bazuar në analizat tona, kjo gjendje ishte për shkak të inicimit të procedurës në fund vit ku nuk ishte bërë vlerësim i mirëfilltë i nevojave për këtë kontratë, si dhe për shkak të shfrytëzimit të mjeteve, të cilat në të kundërtën do të shkonin suficit. Pas përfundimit të auditimit (terrenit), jemi njoftuar nga menaxheri i kontratës se tashmë është bërë furnizimi i pajisjeve të cilat janë vendosur në objektet e dy shkollave të komunës derisa të krijohen kushtet për vendosjen dhe montimin e tyre në muzeun e qytetit.
- Te kontrata "Ndërtimi i sheshit Ahmet Krasniqi në qytetin e Vushtrrisë" prej 93,664€, përmes ekzaminimit fizik kemi evidentuar se pozicioni 1 në kuadër të pjesës D-Punët e veshjeve finale për vendosjen e pllakave të betonit nga gurët natyral nuk ishte realizuar sipas dimensioneve të kontraktuara me kontratë (të kontraktuara ishin këto dimensione: 30*20*12cm ndërsa janë vendosur me dimensionet 60*40*12cm). Përveç kësaj, në kundërshtim me kontratën/projektin, kemi evidentuar se rreth vijës kufizuese të hapësirës së sheshit, pllakat e betonit ishin zëvendësuar me kubëza (kalldrëm vendor) me dimensione 10*10*10cm.
- Te kontrata "Rikonstruimi i hapësirave publike në sheshe (faza II)" prej 50,652€, ku pjesë e kësaj kontrate janë rikonstruimi i katër (4) parqeve, dy prej të cilave i kemi ekzaminuar fizikisht. Në parkun te shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit kemi evidentuar se te pozicioni E.1, vendosja e kubëzave ishte bërë me dimensione 10*20cm, përderisa të kontraktuara ishin me dimensione 20*20cm. Ndërsa pozicioni F.3 për mbjelljen e drunjëve dekorativ ishte paguar total sasia e kontraktuar prej 40 drunjëve ndërsa ishte realizuar sasia prej 30 drunjëve (mbipagesë 10*20=200€). Te parku i Hamamit, kemi evidentuar se pozicioni C10 për furnizimin dhe vendosjen e skajoreve (32 metra gjatësi prej 160€) ishte paguar pa u realizuar fare.

- Te kontratat: "Ndërtimi i 12 rrugëve me kubëza betoni" LOT 1 prej 54,953€ dhe "Ndërtimi i 10 rrugëve me kubëza betoni" LOT 2 prej 84,960€, nga ekzaminimi fizik kemi evidentuar se ka ndryshime në kontratë, mirëpo pa ndryshuar çmimin total të kontratave. Përmes ekzaminimit fizik, kemi evidentuar se në disa rrugë nuk ishin vendosur skajoret (të cilat ishin në kontratë), për shkak të specifikave të rrugës (rruga kufizohej me muret e shtëpive të banorëve dhe ishte bërë zgjerimi i rrugëve deri te muret), mirëpo faturimi ishte bërë për skajore sipas kontratës. Sipas konfirmimit të menaxherit të kontratës të këtyre dy kontratave, në 12 rrugë nuk ishte realizuar vendosja e skajoreve për shkak të konfiguracionit të rrugëve i cekur më lartë. Duhet theksuar se te kubëzimi i Rr. "Daut Ymeri" e kontratës LOT 2, ishin vendosur skajoret me dimensione 10/20cm përderisa të kontraktuara ishin me dimensionet 18/24cm. Pas vërejtjeve tona ishte bërë përmirësimi dhe në këtë rrugë ishin vendosur skajoret sipas dimensioneve të kontraktuara.
- Te kontrata "Ndërtimi i urës në fshatin Doberllukë" prej 99,129€ kemi evidentuar se pozicioni 3.5¹³ në specifikacionin teknik është rritur sasia nga 83m³ në 90m³ apo nga 4,980€ në 5,400€ duke rezultuar me mbi pagesë prej 420€. Duhet theksuar se pas evidentimit tonë kjo ishte përmirësuar dhe ishte bërë kthimi i mjeteve në buxhetin e komunës. Ky lëshim ishte për shkak të mungesës së kontrolleve të ushtruara nga çertifikuesi dhe menaxheri i kontratës.

Të gjitha këto ndryshime në realizimin e kontratave janë bërë pa aprovimet e Zyrarit Kryesor Administrativ dhe zyrës së prokurimit ashtu siç kërkohet me ligjin dhe rregullat/udhëzuesin për prokurimin publik. Duhet theksuar se menaxherët e kontratave nuk ishin në njohuri për kërkesat ligjore për prokurimin publik lidhur me aprovimet e nevojshme për ndryshimin e kontratave.

Ndikimi

Ekzekutimi i punëve në kundërshtim me paramasën dhe paralogarinë e kontraktuar pa aprovimin e zyrës së prokurimit dhe Zyrarit Kryesor Administrativ shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e punëve të kryera si dhe mund të rezultojë që për shkak të ndryshimit të kushteve të kontratës nuk është përzgjedhur operatori më i lirë. Ndërsa pagesat për punë të pa kryera mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe keqpërdorim të parasë publike.

¹³ Pozicioni 3.5: Furnizimi me material, përgatitja e kallupeve, armimi dhe betonimi i mureve, krahoreve dhe shpatullave të urës nga betoni i armuar (hidrobeton) i klasit C-30/37 Mpa (në çmim hyjnë betonimi dhe punimi i kallupeve, shpatullave të urës si dhe punimi i hidroizolimit horizontal dhe vertikal i shpatullave dhe krahëve të urës). Betonimi do të bëhet në kushte të veçanta përfshirë edhe ujin me dimension sipas detalit.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe certifikuesi aplikojnë kontrole efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare dhe ndryshimet e identifikuara, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës dhe realizohen aprovimet e nevojshme për kontratat të cilat ende nuk janë përmbyllur.

Çështja A4 - Mangësi në procedurat e prokurimit

Gjetja Sipas nenit 12.5 i Ligjit NR. 06/L-133 për ndarjet buxhetore 2019 thuhet se Organizata buxhetore nuk duhet të shpallë tender për një projekt kapital të aprovuar në tabelat 3.2, 3.2B dhe 4.2 pas datës 31 tetor 2019 për shpenzim potencial në vitin fiskal 2019, përveç nëse ato shpenzime janë planifikuar për atë projekt kapital edhe për vitet vijuese. Po ashtu, sipas nenit 12.6 të ligjit të buxhetit për vitin 2019, kërkohet që nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare të bëhet nga organizatat buxhetore vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2019 dhe për dy (2) vitet në vijim. Në dy aktivitete të prokurimit nuk ishin përfillur këto kërkesa të ligjit të buxhetit, përkatësisht:

- Komuna pas datës 31 tetor kishte iniciuar aktivitetin e prokurimit për një projekt i cili ishte i aprovuar në tabelën buxhetore 4.2 vetëm për vitin 2019. Përkatësisht me dt. 05.11.2019 ka nënshkruar "Deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmerisë së fondeve (DNPDF)" dhe me dt. 07.11.2019 ka bërë Njoftimin për kontratë për "Furnizimin e pajisjeve për muzeun e qytetit". Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat ligjore për lidhjen e kontratave në fund vit.
- Komuna kishte nënshkruar kontratë dy vjeçare për "Ndërtimin e QMF-së në Vushtrri" prej 346,222€. Kontrata është lidhur në mungesë të mjeteve të mjaftueshme ngase për vitin 2019 në ligjin e buxhetit janë paraparë 85,000€ ndërsa vlerësimi për vitin 2020 është 150,000€ (total 235,000€). Kjo gjendje ishte për shkak të dështimit të planeve për bashkëfinancimin e të këtij projekti, rrjedhimisht projekti është iniciuar me vonesë gjë që ka ndikuar edhe në pamundësinë e sigurimit të mjeteve të mjaftueshme për vitet vijuese.

Ndikimi Nënshkrimi i kontratës në mungesë të mjeteve të mjaftueshme mund të pengojë realizimin e kontratës si dhe mund të ndikojë në prolongimin e realizimit të projekteve të planifikuara.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.

Çështja B6 – Vonesa në realizimin e kontratave

Gjetja Nga pagesat e testuara kemi evidentuar vonesa në realizimin e nëntë¹⁴ (9) kontratave të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2019, mirëpo ende nuk janë përmbyllur gjatë kohës që ne ishim në ekzekutim të auditimit (mars 2020).

Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave ashtu siç kërkohet nga dosja standarde e tenderit në nenin 18. Po ashtu, nuk kishte aplikim të penaleve.

Shkaqet e vonesave kryesisht ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të komunës lidhur me problemet pronësore, specifike të punëve, pa përgjegjshmërisë së OE, kushteve atmosferike etj. Ndërsa mos ndjekja e procedurave për aprovimin e vonesave të nevojshme, ishte për shkak të mungesës së njohurive të menaxherëve të kontratave lidhur me kërkesat ligjore.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuale të cilat pastaj bëhen barrë për buxhetin e vitit pasues. Kjo poashtu ndikon në performancën dhe në arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore, të hartohen specifika adekuate të projekteve dhe se menaxherët e kontratave formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuar nga ana e Komunës. Po ashtu, duhet të aplikohen penalet për vonesat e pa arsyetuara.

¹⁴ Kontrata e dt. 09.10.2019 për "Rikonstruimi i hapësirave publike në sheshe - faza e dytë në vlerë 50,651.65€ - afati për realizimin e kontratës është 45 dite pune; Kontrata e dt. 29.11.2019 për "Furnizimin me pajisje për muzeun e qytetit" prej 37,669€ - afati është 15 ditë kalendarike; Kontrata e dt. 03.03.2018 "Ndërtimi i Qendrës së Kulturës Hasan Prishtina" prej 1,178,132€ - afati për realizimin e kontratës është 30.12.2019; Kontrata e dt. 08.11.2019 për "Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit të futbollit" prej 118,527€ - afati është 35 ditë pune; Kontrata e dt. 23.10.2018 për "Asfaltimin e rrugës Vushtri-Nadakofc-Pestovë faza e parë" prej 282,347€-afati i realizimit të kontratës është dt. 30.08.2019; Kontrata e dt. 31.05.2019 për "Asfaltimi i rrugës Vushtri-Nadakofc-Pestovë - Faza e dytë" prej 198,288.85€ - afati është 90 dite pune; Kontrata e dt. 15.10.2018 për "Ndërtimi i urës në fshatin Doberllukë prej 99,129€ e cila është dashur të përfundonte gjatë vitit 2019; Kontrata e dt. 12.09.2019 "Ndërtimi i fushave sportive" prej 55,466.18€ - afati për realizimin e kontratës është 50 ditë si dhe "Renovimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit" 134.121€.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A5 - Dobësi në procesin e vlerësimit të tenderit

Gjetja Në dy aktivitete të prokurimit kemi evidentuar se nuk ishin respektuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional, ku në rast të grupit të OE, ishte kërkuar që lideri i grupit të ketë jo më pak se 60% të vlerës së përcaktuar të kontratave të ngjashme të përfunduara në tre vitet e fundit. Kjo ishte evidentuar te:

- Aktiviteti i prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve komunale”¹⁵ me vlerë 532,958€. Vlera e kërkuar e projekteve të ngjashme, të përfunduara në tre vitet e fundit ishte jo më pak se 700,000€ përderisa lideri i grupit ka ofruar dëshmi për kontratat e ngjashme prej 219,927€ apo 31% dhe
- Aktiviteti i prokurimit “Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit” me vlerë të parashikuar 1,800,000€. Vlera e kërkuar e projekteve të ngjashme, të përfunduara në tre vitet e fundit ishte jo më pak se 2,500,000€, përderisa lideri i grupit ka ofruar dëshmi për kontratat e ngjashme prej 1,334,049€ apo 53%.

Kjo ka ndodhur për shkak se komisionet vlerësuese, përkatësisht zyra prokurimit ua kanë llogaritur tenderuesve edhe një pjesë të shërbimeve/punëve të kontratave të ngjashme që ishin duke i përfunduar.

Ndikimi Mospërfillja e kërkesave të dosjes së tenderit është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe mund të rezultojë me për zgjedhje të ofertuesve të pa përgjegjshëm duke shkelur parimin e trajtimit të barabartë të tenderuesve.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet të shpërblehen me kontratë.

¹⁵ Titulli i plotë i kontratës: “Sigurimi fizik i objekteve komunale, shkollave, Qendrës për Punë Sociale, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Shtëpisë rezidenciale”

Çështja A6 - Ndarje jo e drejtë e detyrave në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit**Gjetja**

Neni 62.3 i RrUOPP përcakton ndarjen e detyrave në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave. Kemi evidentuar dy aktivitete të prokurimit në të cilat nuk ishin përfillur kërkesat ligjore për ndarjen e detyrave. Përkatësisht te:

- Te kontrata kornizë "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Komunës së Vushtrisë", menaxher të kontratës ishin caktuar dy nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.
- Te aktiviteti i prokurimit "Furnizimi me pajisje për përkrahje të bizneseve" prej 117,194€, punonjësi i cili ka nënshkruar paramasën dhe paralogarinë është caktuar edhe anëtar i komisionit për vlerësimin e ofertave, ndërsa një anëtar tjetër i cili ishte në vlerësim të ofertave ishte caktuar edhe si menaxher i kësaj kontrate.

Kjo mos ndarje e detyrave kishte ndodhë për shkak të stafit të pamjaftueshëm në njësitë të kërkuese.

Ndikimi

Angazhimi i zyrtarëve të njëjtë në disa detyra në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit/kontratave mund të rezultojë në konfliktin të detyrave si dhe mund të ndikojë negativisht në menaxhimin financiar dhe operativ të kontratave.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj që ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në aktivitetet e prokurimit të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të prokurimit, në mënyrë që të shmanget mundësia e konfliktit të detyrave.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale, e paraqitur në PFV ishte 111,991,768€, pasurive jo kapitale ishte 437,913€, dhe e stoqeve 49,218€. Kemi testuar 75 mostra në vlerë 2,325,998€ për teste substanciale, si dhe kemi kryer teste të pajtueshmërisë lidhur me procedurat e brendshme të menaxhimit të pasurive, inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive, funksionimin e sistemit e-pasuria etj.

Çështja C4 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja Testimet për këtë fushë kanë rezultuar me disa mangësi dhe të cilat janë trajtuar si në vijim:

- Sipas nenit 11.3 të Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria kapitale do të klasifikohet si pasuri në përdorim dhe të zbatohet zhvlerësimi. Kemi evidentuar 5¹⁶ pagesa me vlerë të përbashkët 95,726€, të cilat ishin regjistruar si investim në vijim përderisa është dashur të regjistrohen si pasuri në përdorim për arsye se projektet kishin përfunduar dhe ishin bërë pranimet teknike. Përderisa në një rast tjetër pagesa në vlerë 31,987€ është regjistruar si pasuri në përdorim dy herë, ngase e njëjta ishte e përfshirë edhe te regjistrimi me totalin e kontratës prej 54,953€ "LOT 1 Ndërtimi i 12 rrugëve me kubëza betoni".
- Sipas Nenit 11 i Rregullores Nr. 02/2013, pasuritë që gjenden në fazën e investimeve në vijim duhet të regjistrohen në kategorinë e investimeve në vijim, si dhe pas përfundimit të investimit pasuria duhet të klasifikohet si pasuri në përdorim. Kemi evidentuar se pagesa prej 33,925€ për kontratën e përfunduar "Ndërtimi i shkollës Bajram Curri në fshatin Dumnicë e Mesme", ende figuronte në regjistër të pasurive kapitale si investim në vijim. Llogaria e investimit në vijim është dashur të mbyllet ngase regjistrimi ishte bërë si pasuri në përdorim me vlerën totale të kontratës.
- Pagesa 10,938€ për "Mirëmbajtja dhe rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuara" është regjistruar si investim në vijim ndonëse është dashur të regjistrohej si rritje e vlerës së rrugëve të cilat janë ri konstruktuar.

¹⁶ 54,250€ për kontratën "Ndërtimi i 10 rrugëve me kubëza betoni", 17,091€ dhe 3,896€ të kontratës "Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse", 13,720€ "Rregullimi i kulmeve të AMF-ve" dhe 6,768.78€ "Renovimi i objekteve shkollë - faza e dytë"

- Regjistrimi i automjeteve ndër të tjera është përcaktuar me nenin 39 dhe 43.1 të Ligjit Nr. 05/L-132 për automjetet. Pagesa prej 26,900€ për furnizimin me automjet ngarkues Eskavator Skip, ishte regjistruar si pasuri në përdorim, mirëpo i njëjti nuk ishte regjistruar në emër të të komunës të Qendra për Regjistrimin e Automjeteve. Përkatësisht, nuk ishte nxjerr certifikata e regjistrimit të automjetit që tregon personin juridik/fizik në emrin e të cilit është mjete. Duhet theksuar se i njëjti i është dhënë në shfrytëzim Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Uniteti" për afat të pacaktuar.
- Sipas Nenit 6.1 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkohet që regjistri i pasurive të mbahet ndaras për çdo pasuri. Kemi evidentuar se pagesat për kontratën "Asfaltimi i shtatë (7) rrugëve lokale" prej 308,725€ ishin regjistruar me një numër identifikues për vlerën totale të kontratës. Përderisa regjistrimi është dashur të bëhej ndaras me numër të identifikimit të ndryshëm sipas rrugëve të asfaltuara. Rrjedhimisht kjo gjendje ka shkaktuar një pasqyrë jo të drejtë të regjistrimit të pasurive kontabël.
- Nga testimi i pasurive nën 1,000€ kemi evidentuar 4 blerje, me vlerë 8,688€, të cilat nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Ndërlidhur me këtë kemi verifikuar se ende ka probleme me funksionimin e "e-pasurisë" ngase ajo në disa raste nuk aplikon zhvlerësimin si dhe ka probleme me emërtimet e pasurive të regjistruara.
- Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare ashtu siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013. Po ashtu nuk është bërë vlerësimi i pasurive jo financiare.

Regjistrimet e gabuara kryesisht ishin për shkak të volumit të madh të punëve në fund vit, pakujdesisë së zyrtarit të pasurive dhe mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare. Ndërsa mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi C4 Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimi dhe vlerësimit të pasurive do të kryet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.

2.3 Të arkëtueshmet

Në PFV-të e vitit 2019, komuna ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,101,196€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa për grumbullimin e mbeturinave, taksa në firmë, lejet ndërtimore, shfrytëzimi i pronës publike, tatimi në tokë dhe të tjera.

Çështja B7 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Nga viti paraprak ato janë rritur për 652,680€ apo rreth 19%, rritja më e madhe ishte tek taksa për grumbullimin e mbeturinave. Ndonëse komuna kishte ndërmarrë disa veprime për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë (borxhet më të mëdha ndaj komunës) ato veprime nuk ishin të mjaftueshme. Duke parë trendin e madh rritës, mbledhja e taksave mbetet sfiduese, e në veçanti të arkëtueshmet për grumbullimin e mbeturinave për të cilat është fillimi i menaxhimit të këtyre të hyrave.

Te shpalosjet e të arkëtueshmeve në pasqyra financiare, saldot fillestare ishin nënvlerësuar për 3,466€ tek taksat në biznes Kjo gjendje ishte për shkak të neglizhencës dhe kompetencës së zyrtarëve që menaxhojnë me këto të dhëna.

Përderisa disa llogari menaxhohen nga sisteme të integruara (tatimi në pronë, taksa në biznes dhe mbeturina), llogaritë tjera menaxhohen në Excel dhe të dhënat e prezantuara nuk japin siguri të plotë për saktësinë dhe plotësinë e tyre.

Ndikimi Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme rezulton me rritje të këtyre llogarive, rrezikon që komuna të ketë humbje financiare si dhe rrezikon mos realizimin e projekteve të komunës të financuara nga të hyrat vetjake. Mos raportimi i plotë i llogarive të arkëtueshme si dhe menaxhimi i të dhënave në Excel ndikon saktësinë dhe plotësinë e informatave për të arkëtueshmet dhe shpalosjen e tyre në PFV.

Rekomandimi B7 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 106,760€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Çështja C5 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave

Gjetja Rregullorja Financiare 02/2013 MF, neni 5, konsideron si obligim të vonuar për pagesë, faturën e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimit të saj. Nga 7 rastet e testuara, në dy prej tyre me vlerë 40,122€ kishte vonesa në pagesat e faturave, njëra 6 ditë dhe tjetra 42 ditë vonesë. Vonesat në pagesat e faturave kane rrjedhur si shkak i mungesës së alokimit të mjeteve.

Ndikimi Vonesat në pagesa mund të krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues.

Rekomandimi C5 Kryetari, duhet të sigurojë kontrollë shtesë në ekzekutimin e pagesave, për të eliminuar vonesat në pagesën e faturave.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019 ishte 3,246,346€. Kemi testuar tetë mostra.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Sipas të dhënave që na janë ofruar nga komuna, gjendja e detyrimeve kontraktuale të me datën 31.12.2019 ishte 4,329,527€¹⁷. Kjo vlerë është nxjerrë nga lista e bashkëfinancimeve dhe raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë - drejtori dhe një auditor. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe vjetor të punës ku ishin përfshirë gjashtë (6) auditime. Të gjitha këto auditime ishin përfunduar dhe poashtu edhe tri (3) auditime tjera, në kuadër të përcjellës së rekomandimeve të NJAB-së. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 21, të zbatuara ishin 15, në proces ishte 5 dhe një i pazbatuar.

¹⁷ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, pasurive, vlerësimit të kontrolleve në drejtorinë e financave, arsimin si dhe drejtorinë e bujqësisë. Përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2019.

Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur katër (4) takime ku ishte diskutuar për raportin e auditorit të jashtëm dhe të NJAB-së, me fokus në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA.

Çështja A7 - Mos kompletimi i NJAB-së

Gjetja Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi 7 milion€ duhet të ketë së paku tre auditorë. NJAB në Komunën e Vushtrisë përbëhet nga drejtori dhe një anëtar.

Ndikimi Mos kompletimi i NJAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Rekomandimi A7 Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Komunës së Vushtrisë për vitin 2018 ka rezultuar me 16 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna po ashtu ka përgatitur raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit Megjithatë konstatimet e zyrtarëve komunal të vendosura në këto raporte nuk përputhen plotësisht me gjendjen e konstatuar nga auditimi. Edhe gjatë diskutimeve me zyrtarët komunal është pranuar fakti se komuna qëndron keq me zbatimin e rekomandimeve. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 2 rekomandime janë zbatuar; 5 ishin në proces dhe 9 nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime konkrete duhet të ndërmerren për të eliminuar gabimet në planifikimin/buxhetimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre. Gjithashtu, informatat lidhur me shpalosjen e të arkëtueshmeve duhet të jenë të plota me qëllim të prezantimit të tyre të plotë dhe të saktë në PFV.	Komuna e ka bërë shpalosjet e të gjitha llogarive të arkëtueshme, mirëpo çështja e keqklasifikimit të shpenzimeve mbetet njejtë	Rekomandi m në proces të zbatimit Ref. C1
2	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime bëhen konform ligjit të buxhetit dhe kodeve ekonomike të përcaktuara sipas planit kontabël për kategori.	Gjatë auditimit nuk kemi hasur pagesa për shpenzime kapitale të kryera nga kategoria e mallrave, mirëpo keqklasifikimi i shpenzimeve të pagave sipas vendimeve gjyqësore mbetet njejtë edhe këtë vit	Rekomandi m i pa zbatuar Ref. B4
3	Të Hyrat	Kryetari, duhet të sigurohet se vlerësimet e gjendjes në terren të pronave janë të reflektuara edhe në sistemin për kalkulimin e tatimit në pronë. Po ashtu, në sistem duhet plotësohen informatat që e mundësojnë identifikimin e përfitimit nga zbritja e vendbanimit kryesor. Krejt kjo me qëllim të rritjes së të hyrave nga tatimi në pronë.	Nuk kemi hasur raste të ngjashme te pika e parë, mirëpo ende ka tatimpagues pa numër personal në Protax.	Rekomandi m në proces të zbatimit Ref. C2
4	Paga dhe Mëditje	Kryetari, duhet të emërojë komisione profesionale dhe të siguroj se komisionet gjatë procesit të vlerësimit i respektojnë plotësisht kriteret e kërkuara në mënyrë që të sigurohet që vetëm kandidatët meritator kanë fituar pozitat e punës.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur çështje të ngjashme	Rekomandi m i zbatuar
5	Paga dhe Mëditje	Kryetari, duhet të siguroj se angazhimi me MSHV bëhet vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se	Edhe këtë vit gjendja është e njejtë	Rekomandi m i pazbatuar Ref. B2

		buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.		
6	Mallra dhe Shërbime	Kryetari duhet të siguroj që me rastin e furnizimeve, pranimi i tyre të bëhet nga menaxherët përkatës përmes hartimit të raporteve në bazë të udhëzimeve përkatëse dhe se asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë ngase kemi hasur raste të pagesave në mungesë të raporteve, dhe pa pranim të mallit.	Rekomandi m i pazbatuar Ref. B3
7	Mallra dhe Shërbime	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale, dhe në rastet e vonesave në liferimin e mallrave dhe shërbimeve të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë ngase kemi hasur raste të vonesave në liferimin e mallrave.	Rekomandi m i pazbatuar Ref. B1
8	Subvencione & Transfere	Kryetari duhet të siguroj që kriteret në thirrjet publike për aplikim të jenë të matshme, specifike dhe të qarta, duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës. Po ashtu, duhet të rriten kontrollet monitoruese pas shpërndarjes së subvencioneve.	Çështja e kriterëve të pa shkruara është përsëritur edhe këtë vit, ndërsa për çështjen e raportimit të përfituesve nuk kemi hasur raste gjatë këtij viti.	Rekomandi m në proces te zbatimit Ref. C3
9	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet për të siguruar se janë hartuar projektet ekzekutive sipas RrUOPP për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Proceset e prokurimit për projekte ekzekutive duhet të kryhen në fillim në mënyrë që t'i paraprijnë inicimit të prokurimit të projekteve tjera për punë.	Gjendja është e njëjtë edhe këtë vit	Rekomandi m i pa zbatuar Ref. B5
10	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të vonesave dhe të sigurojë që planet dinamike të përputhen me afatet reale të përfundimit të punëve, si dhe të sigurojë se për çdo projekt ekziston projekti ekzekutues. Po ashtu, duhet të analizohen dhe shqyrtohen shkaqet që kanë ndikuar në ngeçjet e projekteve si pasojë e dobësive në proceset e prokurimit dhe të marrë masa për përmirësimin e menaxhimit të tyre.	Gjendja është e njëjtë edhe këtë vit ngase kemi hasur vonesa në realizimin e projekteve kapitale.	Rekomandi m i pa zbatuar Ref. B6
11	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit paraprakisht një analizë dhe vlerësim objektiv të kriterëve që	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë këtij viti.	Rekomandi m i zbatuar

		duhet të vendosen në dosje të tenderit, me qëllim të krijimit të konkurrencës së operatorëve duke marrë ofertën më përfituese për Komunën. Ndryshimet e tilla të kushteve të kontratës nuk duhet të lejohen.		
12	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPF.	Edhe në këtë vit gjendja është e njëjtë	Rekomandimi pa zbatuar Ref. B4
13	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari, duhet të sigurohet që regjistri i pasurive azhurnohet me të gjitha informatat relevante në mënyrë që të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive duke mos e nënvlerësuar e as mbivlerësuar pasurinë në PFV. Në këtë aspekt duhet të sigurojë kontrolle në evidentimin e plotë të pasurisë kapitale dhe jo kapitale.	Ne këtë vit nuk kemi hasur mos regjistrim të pasurive kapitale, përderisa ka probleme me regjistrime jo adekuat si dhe pasuria ende ka probleme me aplikimin e zhvlerësimit	Rekomandimi në proces të zbatimit Ref. C4
14	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duhet të sigurojë procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimin të tyre. Posedimi i një plani dhe programi operativ dhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve do ta rrisin nivelin e mbledhjes së borxheve.	Edhe në këtë vit ka vazhduar trendi rritës i LLA	Rekomandimi i pazbatuar Ref. B7
15	Obligimet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet sipas rregullës financiare 02/2013.	Nuk kemi vërejtur mos raportim të faturave nëpër muajt përkatës, përderisa kishte vonesa në pagesën e faturave.	Rekomandimi në proces të zbatimit Ref. C5
16	Raportimi menaxherial	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të sigurojë se është përcaktuar forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.	Komuna kishte nxjerrë një shabllon të raportimit të brendshëm, por ai nuk ishte përdorur në të gjitha rastet.	Rekomandimi mbyllur i pazbatuar.

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit Ref. C1	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që të gjitha shpenzimet të planifikohen në kategoritë e duhura buxhetore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate. Këtu duhet të përfshihen planifikimi i mjeteve për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse për ish punëtorët që nuk janë kompensuar si dhe ata që janë në prag të pensionimit, si dhe klasifikimi/ndarja e qartë e projekteve kapitale nga shpenzimet tjera si subvencionet apo mallrat dhe shërbimet.
2	Te hyrat Ref. C2	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen.
3	Te hyrat Ref. A1	Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren.
4	Pagat dhe Mëditjet Ref. B1	Kryetari, duhet të siguroj se MSHV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.
5	Mallra dhe shërbime Ref. B2	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve të kontraktuara, dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.
6	Mallra dhe shërbime Ref. B3	Kryetari duhet të siguroj që të bëhet monitorimi i zbatimit të kontratave përmes hartimit të raporteve nga menaxherët përkatës, dhe se asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen nga ana e OE.
7	Mallra dhe shërbime Ref. B4	Kryetari duhet të thelloj bashkëpunimin me MF, për të siguruar që mjetet për kryerjen e obligimeve që dalin nga marrëveshja kolektive të buxhetohen dhe të paguhen me kohë dhe nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, për të shmangur keqklasifikimin dhe shpenzimet e panevojshme.
8	Subvencione dhe transfere Ref. C3	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës, si dhe përfitues të subvencioneve të jenë vetëm aplikuesit që përmbushin kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. Po ashtu, Kryetari duhet të ndërtojë mekanizma mbikëqyrës për tu siguruar se subvencionet e dhëna arrijnë qëllimet e synuara.
9	Investime kapitale Ref. A2	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve) dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit

		nga Zyrtari Administrariv.
10	Investime kapitale Ref. B5	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.
11	Investime kapitale Ref. A3	Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm sipas çmimeve të kontraktuara dhe punëve/furnizimeve të realizuara. Po ashtu, për gabimet financiare dhe ndryshimet e identifikuar, komuna duhet të sigurohet se do të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës dhe realizohen aprovimet e nevojshme për kontratat të cilat ende nuk janë përmbyllur.
12	Investime kapitale Ref. A4	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.
13	Investime kapitale Ref. B6	Kryetari duhet të siguroj që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore, të hartohen specifika adekuate të projekteve dhe se menaxherët e kontratave formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuar nga ana e Komunës. Po ashtu, duhet të aplikohen penalet për vonesat e pa arsyetuera.
14	Çështje të përbashkëta Ref. A5	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet të shpërblehen me kontratë.
15	Çështje të përbashkëta Ref. A6	Kryetari duhet të siguroj që ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në aktivitetet e prokurimit të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të prokurimit, në mënyrë që të shmanget mundësia e konfliktit të detyrave.
16	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale Ref. C4	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimi dhe vlerësimit të pasurive do të kryet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në OB.
17	Të arkëtueshmë et Ref. B7	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim.
18	Detyrimet e papaguara Ref. C5	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në ekzekutimin e pagesave, për të eliminuar vonesat në pagesën e faturave.
19	Auditimi i brendshëm Ref. A8	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letra e konfirmimit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRIN

OZ Nr. / Br. 417/20

Nr. i fq. / Br. st.

Data: / Datum 22. 05. 2020

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE PËRANUAR DHE ZBATIM: 27. 05. 2020

Niveli Org. / Org. Jedin. / Org. Unit	Shif. klasif. / Klasif. Kod / Class. Code	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Nr. i faqeve / Br. Stranica / No. Pages
04	42	685	1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Xhafer Tahiri.....

Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Data: 22.05.2020, Vushtrri,

